



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 29-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 18.01.2021, në sallën e kuvendit me fillim në ora 13⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Hyra Bytyçi, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani
4. Albulena Kelmendi, anëtare
5. Ukë Kryeziu, anëtar
6. Afrim Miftari, anëtar
7. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Emina Rexhiq, DPU
2. Latif Ramadani, DBF
3. Merita Bytyqi, DSH
4. Bekim Shabani, DEZH

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 28-të e KPF-së.
2. Raporti Janar-Dhjetori shpenzimeve e te hyrave 2020

3. Propozim Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës 15Nr.320-61046 i datës 28.09.2018.
5. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 15Nr.500-48448 i datës 30.07.2019 për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit të Komunës së Lipjanit për kujdes parësor shëndetësor
6. Propozim vendim për pezullimin të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubofc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019.
7. Propozim vendim për plotësimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në fshatin Llugaxhi 15Nr.463-20391 i datës 29. 03. 2019
8. Propozim vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës.
9. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.
10. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete.
11. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB-së

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi tha se në plan të punës ka qenë edhe informata e drejtoratit të shëndetësisë rreth pandemisë Covid 19 në Komunën e Lipjanit, mirëpo për shkak se kuvendin e kemi thirrë më herët nuk ka muajt me u përgatite kjo pike por do ta keni në seancën e muajit shkurt.

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreh rendit të ditës?

Lumturie Bytyqi-Hasani, nëse e ka gati raportin drejtorati i shëndetësisë do të ishte mirë me e pas për këtë seancë.

Kryesuesi tha se po e hodhi në votim ashtu siç e lexova më herët rendin e ditës.

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat 7 për aprovoi:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 28-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 28-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e katër të rendit të ditës

II

Raporti Janar-Dhjetori shpenzimeve e te hyrave 2020

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, dha se për këtë pikë drejtori është prezent por nëse ju pajtoheni e procedojmë për kuvend.

Pastaj Kryesuesi vuri në votim propozimin që të kalojë direkt në kuvend, me 7 vota për kaloi kjo pikë..

III

Propozim Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Bekim Shabani, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari, kërkoj një sqarim të neni 5 pika 2.2, ku janë të cekura se cilat prona mund të ipen, por çka nëse kërkojnë ata që përfitojnë me gjatë me pas atë pronë, pse nuk është përcaktuar afati kohor se sa ka të drejtë me pas atë pronë.

Bekim Shabani,na edhe më herët kemi pas raste kur ju kemi dhanë prona siç ka qenë qen kinemaja në Shalë ku komuna e ka marr përqindjen e biletave.

Deri në 10 ditë epet me pëlqim të Kryetarit ndërsa më shumë se 10 ditë komisioni i caktuar nga Kryetari.

Ukë Kryeziu,sa herë ka të drejt të njëjtën pronë ta ketë,çka nëse ai person e bllokoi atë pronë nuk bën asnjë aktivitet.

Daut Azemi,gjatë marrëveshjes do të precizohen të gjitha kushtet.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës 15Nr.320-61046 i datës 28.09.2018.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën,Emina Rexhiq drejtoreshë e DPU, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 15Nr.500-48448 i datës 30.07.2019 për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit të Komunës së Lipjanit për kujdes parësor shëndetësor

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën,Merita Bytyqi, drejtoreshë e DSH, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani,unë e pata kundërshtu kur pat ardh për herë të parë këtë propozim pasi qe ka qenë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi,atëherë e kemi kundërshtu dhe prap do te votoj kundër.

Merita Bytyqi,neve na obligon ministria e shëndetësisë te gjitha komunave me qit ne kuvend.

Ukë Kryeziu, unë e pata kundërshtu edhe në KPF këtë propozim dhe pata thanë qe nuk ka nevojë me u ngut para nivelit qendror me bo një propozim.

Daut Azemi,sa i perket propozimit nuk ka pas asnjë vertje

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi